Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/608
Datë: 13.10.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Udhëzimit Administrativ (UA Nr. 31/2014, datë 05.09.2014), për Njohjen e Mësimit Paraprak, Udhëzimit Administrativ (UA Nr.09/2019, datë 18.06.2019) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullore Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur më datë 05.10.2023 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. **Akreditohet** Institucioni i Aftësimit Profesional "Shehu" me adresë: Parku i Biznesit Drenas, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 05.10.2023 deri 04.10.2026, për zbatimin e Njohjes se Mësimit Praraprak (NjMP), me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 **Zdrukthëtar, Niveli IV sipas KKK,** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 30 kredi të AAP. IAP mund të përfshijë në procesin e Njohjes së Mësimit Paraprak katër (4) kandidatë brenda muajit.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Institucioni i Aftësimit Profesional "Shehu" ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak për kualifikimin zdrukthëtare niveli IV sipas KKK. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
Pas realizimit të vizitës në këtë institucion nga ekipi i ekspertëve dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipi i ekspertëve në raportin përfundimtar të hartuar me datë 02.08.2023 ka dhënë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitën e ekipit të ekspertëve në IAP "Shehu" si dhe dokumente tjera shtesë. Ekipi i eksperteve ka rekomanduar që IAP "Shehu" të aplikoj për proces të ri-validimit dhe ri-akreditimit gjatë muajit shtator të vitit 2023, pasi që institucionit i skadon akreditimi dhe validimi i kualifikimit në muajin dhjetor 2023, dhe me rastin e skadimit të validimit të kualifikimit IAP "Shehu" nuk ka të drejtë të regjistroj kandidatë për zbatimin e NJMP-së.

Andaj, në bazë të kërkesës së IAP "Shehu" për akreditim për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak për kualifikimin Zdrukthëtar si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në Raportin e vlerësimit për akreditim për zbatim të NJMP-së për institucionin aplikues, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. IAP" Shehu"
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së